



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.119

31 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.623, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar	5849
Vendim i KM nr.624, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja”, të ndryshuar	5855
Vendim i KM nr.626, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, të ndryshuar	5857
Vendim i KM nr.627, datë 8.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.432, datë 13.7.2007 “Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar	5858
Vendim i KM nr.628, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr. 413, datë 26.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës, si dhe të strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të autoritetit të Aviacionit Civil”	5859
Vendim i KM nr.629, datë 8.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar	5861

Vendim i KM nr.630, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të shtëpisë së pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës”, të ndryshuar 5862
Vendim i KM nr.631, datë 23.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve për vitin 2010, në ministritë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar 5864
Vendim i KM nr.632, datë 23.7.2010	Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 5866
Vendim i KM nr.633, datë 23.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar 5870
Vendim i KM nr.638, datë 28.7.2010	Për caktimin e tarifave të pagesës së këshilltarëve profesionistë dhe agjentëve që merren me riatdhesimin e vlerave monetare e të produkteve të krimit, të sekuestruara brenda e jashtë shtetit, dhe debitorëve të tjerë të përfshirë në veprimtarinë e firmave piramidale 5873
Vendim i KM nr.639, datë 28.7.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e pagës së kryetarit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike 5873
Vendim i KM nr.640, datë 28.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në komunën e Farkës, qarku Tiranë 5874
Vendim i KM nr.641, datë 28.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Përmetit 5875
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Bajram Maçi 5876

VENDIM
Nr.623, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) në titullin e vendimit, pas fjalëve “... në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, shtohen “...dhe në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”;

b) në titullin e kreut 1/1 të lidhjes nr.1 të përmendur në pikën 1, pas fjalëve “... në Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë”, shtohen fjalët “... dhe në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar Tiranë”.

c) Në titullin e kreut 1/3 të lidhjes nr.1 të përmendur në pikën 1, pas fjalëve “... Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve Tiranë”, shtohen fjalët “... dhe infermierët në institucionet e tjera të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”.

2. Punonjësit e infermieristikës të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët, deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përfitonin një page më të lartë se paga e parashikuar sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi, do të përfitojnë një pagë në ruajtje, por jo më shumë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Paga në ruajtje llogaritet si diferencë, midis pagës bruto që punonjësit përfitonin para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me pagën bruto që punonjësit do të përfitojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e miratuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave të punonjësve buxhetorë, për secilën ministri, për vitin 2010.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR
OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË
“SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA F POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	30 500	3 600	Nga deri lekë
2	Kryeinfermier shërbimi psikiatrik		2%	0	30 500	6 000	
3	Kryelaborantë në shërbimin e anatomisë patologjike Kryeinfermier shërbimi i terapisë intensive Kryeinfermiere shërbimi onkologjik Kryelaborant rrezatim kobalti Kryelaborant në histopatologji Kryeinfermierë të repartit të rrezatimit		2%	0	30 500	3 400	
4	Kryeinfermiere reparti psikiatrik		2%	0	30 500	5 000	
5	Kryeinfermierë shërbimi Neurokirurgji Kryemami e përgjithshme Kryeinfermier/kryemami reparti i terapisë intensive		2%	0	30 500	2 600	
6	Kryeinfermierë kimioterapi Kryelaborant klinik biokimik Kryeinfermierë në urgjencën e sëmundjeve të brendshme Kryeinfermierë/mami salle Kryeinfermiere/mami e dhomës së zgjimit Infermierë në hemodinamikë Kryelaborant, imunolog,bakteriolog		2%	0	30 500	1 800	
7	Kryeinfermierë shërbimi (kirurgji,neurologji,djegje plastik,kardiokirurgji,maksilofacial, infektiv,pediatrik infektive,obsetrik) Kryeinfermier/kryemami në repartin e kirurgjisë Kryemami turni në kirurgji Kryemami turni në obstetrikë Kryeinfermierë reparti infektiv Kryeinfermierë reparti (fizioterapi,urologji,urgjencës së neurologjisë,neurokirurgji, onkologji) Kryeinfermiere/ kryemami sallë operacioni		2%	0	30 500	1 100	
8	Kryeinfermiere shërbimi Kryelaborante shërbimi Kryemami shërbimi		2%	0	30 500		
9	Infermiere/laborant në psikiatri		2%	0	28 500	5 000	

10	Infermiere në kyriterapi Laborant histopatolog		2%	0	28 500	3 400	
11	Infermiere/mami reanimacioni, neonatologji Infermiere në dhomën e zgjimit		2%	0	28 500	2 650	
12	Infermiere në kimioterapi		2%	0	28 500	1 800	
13	Kryelaborant radiologjie		2%	0	28 500	1 500	
14	Specialist i sektorit të kujdesjeve infirmierore Kryeinfermiere e edukimit shëndetësor TB		2%	0	28 500	1 100	
15	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë Kryeinfermierë në sterilizim Kryemami në izolim		2%	0	28 500		
16	Laborant radiolog në onkologji		2%	0	25 000	3 700	
17	Laborant rrezatim kobalti		2%	0	25 000	3 400	
18	Laborant në mjekësinë bërthamore		2%	0	25 000	2 650	
19	Infermiere në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale Infermierë në sallën e operacionit		2%	0	25 000	2 100	
20	Kryeinfermier reparti pranim urgjence Laborant klinik biokimik Infermier në punkt të gjakut Infermier në hematologji Infermier në onkologji Infermiere endoskopie Infermier/laborant bakteriolog,imunolog		2%	0	25 000	1 800	
21	Infermiere reparti radiologjik Laborant radiolog Kryeinfermiere (pranim urgjence,djegje plastike, kirurgji)		2%	0	25 000	1 500	
22	Infermiere/mami (kirurgji, maksilofaciale,neurokirurgji, kardiokirurgji,djegje plastike, obstetrike) Instrumentarë		2%	0	25 000	1 100	
23	Kryeinfermiere neonatologji Kryemami në qendrën e gruas Kryemami pranimi Kryeinfermiere në kabinetin e dializës Kryemami/ kryeinfermiere reparti kryeinfermiere konsultash në sëmundjet e brendshme Kryelaborant,bakteriolog, imunolog, ortopedi stomatologjike) Infermierë sterilizimi		2%	0	25 000		
24	Infermierë pavioni rrezatimi		2%	0	24 000	3 310	
25	Infermierë (infektiv, pranim urgjence,njësia e koordinimit të urgjencës)		2%	0	24 000	1 800	
26	Ndihmësfarmacist Infermierë në hemodializë		2%	0	24 000	1 500	
27	Infermier fizioterapi		2%	0	24 000	1 100	
28	Laborant (ezhe,ortopedi, stomatologji) Kryeinfermiere çerdhe për personelin infermier		2%	0	24 000		

	Infermier çerdhe për personelin kujdestar në pediatri						
29	Kujdestar në psikiatri		2%	0	20 900	5 000	

Lidhja 1 (kreu 1.2)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË
RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE,
AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	30 500		Nga deri . lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	28 500		
3	Ndihmësinsektor sanitar, ndihmëshigjienist, Ndihmësepidemiolog Laborantë toksikologë Laborant bakteriologë/klinikë biokimikë		2%	0	25 000	1 100	
4	Infermierë në shërbimet e shëndetit mendor		2%	0	25 000	5 000	
5	Infermierë (hematologji, onkologji) Laborant rontgeni		2%	0	25 000	1 500	
6.	Infermier statistike		2%	0	24 000		
7	Infermier ortopedi Infermier/ laborant në fizioterapi		2%	0	24 000	1 100	
8	Kryeinfermier/kryemami Infermier në shërbimin stomatologjik Ndihmësdentist		2%	0	24 000		
9	Ndihmësbakteriolog Infermier/mami		2%	0	20 900		

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË SPITALET E
RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË
FËMIJËVE TIRANË**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike		2%	0	30 500	6 000	Nga..deri lekë
2.	Kryeinfermier reparti në spitale psikiatrike		2%	0	30 500	5 000	
3.	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	30 500	1 100	
4.	Laborant në anatominë patologjike		2%	0	28 500	3 400	
5.	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakteriologjik Kryeinfermier (kirurgji, reanimacion, sallë operacioni, obstetrikë gjinekologji)		2%	0	28 500	1 100	
6.	Kryeinfermieri		2%	0	28 500		
7.	Infermiere në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	25 000	5 000	
8.	Infermiere reanimacioni Ndhmësanestezistë Ndhmësfarmacistë Laborant radiologjie Infermierë në radiologji Instrumentarë Infermiere në hemodializë		2%	0	24 000	1 500	Nga..deri lekë
9.	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiat, infektiv, dispanserit të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji, pneumoftiziat, onkologji, dispanserit) Infermiere në repartin e lindjes Infermier/ laborant në bankën e gjakut, hematologji Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji Përgjegjës turni		2%	0	24 000	1 100	
10	Kryeinfermiere në qendrën e sterilizimit Infermier pranimit urgjence. Laborant klinik biokimik/bakteriologjik		2%	0	24 000	600	
11	Infermier		2%	0	24 000		
12	Kujdestar në psikiatri		2%	0	20 900	5 000	
13	Kujdestar në pediatri Ndhmësinfermier		2%	0	20 900		

Lidhja 1 (kreu 1.4)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË LABORATORIN E KONTROLLIT TË
BARNAVE**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Laborant		2 %	0	30 500		Nga..deri lekë

Lidhja 1 (kreu 1.5)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË KLINIKËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Kryeinfermier		2 %	0	30 500		Nga..deri lekë
2.	Infermier Ndihmësstomatolog		2 %	0	24 000		Nga..deri lekë

Lidhja 1 (kreu 1.6)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Kryeinfermier/kryelaborant		2 %	0	28 500		Nga..deri lekë
2.	Infermier, laborant		2 %	0	24 000	1 100	Nga..deri lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR TEKNIKËT NË NJËSINË E TRANSPORTIT MJEKËSOR ME
HELIKOPTERË**

PAGA MUJORE							
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Teknik i përgjithshëm, teknik elektrik		2 %	0	28 500		Nga..deri lekë

**VENDIM
Nr.624, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.495, DATË 1.8.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKES SË SHQIPËRISË,
NË SHTETET E HUAJA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3/1, që përmendet në pikën 9, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**PAGA MUJORE E PERSONELIT DIPLOMATIK TË PËRFAQËSIVE
DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA**

Pozicioni	PAGA MUJORE	
	1	2
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USD)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1250 euro 1520 dollarë USD	75 %
Konsull i Përgjithshëm	960 euro	75 %
Ministër Fuqplotë	1165 dollarë USD	40 %
Ministër Këshilltar		40 %
Këshilltar	805 euro 1020 dollarë USD	40 %
Sekretar i Parë, Konsull	660 euro 815 dollarë USD	40 %
Sekretar i Dytë, Zëvendëskonsull	520 euro 665 dollarë USD	40 %
Sekretar i Tretë, Agjent konsull	470 euro 575 dollarë USD	40 %
Atashe	420 euro 520 dollarë USD	40 %

**PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË), TË
PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA**

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar Teknik Financier Specialist	820 euro 920 dollarë USD	780 euro 885 dollarë USD	750 euro 850 dollarë USD	725 euro 830 dollarë USD	670 euro 780 dollarë USD
Shofer	780 euro 885 dollarë USD	740 euro 840 dollarë USD	705 euro 810 dollarë USD	680 euro 790 dollarë USD	630 euro 750 dollarë USD
Kafaz	650 euro 715 dollarë USD	620 euro 690 dollarë USD	590 euro 660 dollarë USD	560 euro 630 dollarë USD	520 euro 580 dollarë USD

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PJESSHME) TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)	
	Minimumi	Maksimumi
Sekretar teknik Financier Specialist	300 euro 330 dollarë USD	455 euro 510 dollarë USD
Pastrues	230 euro 250 dollarë USD	310 euro 340 dollarë USD

**VENDIM
Nr.626, datë 8.7.2010**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 18.7.2003, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - c) Pika 5/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, pas miratimit, rast pas rasti, nga njësia e personelit.”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara, për vitin 2010.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

PAGA MUJORE					
KLASA	EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I - a	Sekretar i përgjithshëm	1	2 %		126 000
II - a	Ndihmëskomisioner, kategoria e parë	1	2 %		105 000
II- b	Ndihmëskomisioner, kategoria e dytë Drejtor drejtorie	1	2 %		88 000
III - a	Përgjegjës sektori	1	2 %		71 000
IV - b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2 %		33 000

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

VENDIM
Nr.627, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.432, DATË 13.7.2007 “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 22 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.432, datë 13.7.2007, lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR
PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT**

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për vjetërsi në%	Shtesa për gradë në%
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	19 000	1%	2 %
		I.2	22 000	1%	2 %
		I.3	25 500	1%	3 %
		I.4	28 500	1%	5 %
		I.5	37 000	1%	6 %
		I.6	38 000	1%	6 %
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	42 000	1%	8 %
		II.2	45 000	1%	12 %
		II.3	46 500	1%	12 %
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	49 500	1%	14 %
		III.2	51 000	1%	16 %
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	55 000	1%	20 %
		IV.2	63 000	1%	20 %
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në SHISH		124 000	0%	0 %

VENDIM
Nr.628, datë 8.7.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS, SI DHE TË
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AUTORITETIT TË
AVIACIONIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.10233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.413, datë 26.5.2010, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.3 është sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, në Autoritetin e Aviacionit Civil, që punojnë në pozicione punë që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	1	2%		105 000	15 000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	1	2%		88 000	15 000
Drejtor drejtorie	II-b	1	2%		88 000	0
Përgjegjës sektori Inspektor auditit	III-a	1	2%		71 000	0
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%		62 000	0
Inspektor Specialist	III-b	1 ose 2	2%		54 000	0
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000	0

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

VENDIM
Nr.629, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 “PËR PAGAT DHE SHTESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.	KLASA	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	19 000
2.	II	19 250
3.	III	19 550
4.	IV	19 850
5.	V	20 160
6.	VI	20 480
7.	VII	21 550
8.	VIII	22 550
9.	IX	23 100
10.	X	24 150
11.	XI	25 200
12.	XII	25 750
13.	XIII	26 250
14.	XIV	27 300
15.	XV	29 400
16.	XVI	30 450
17.	XVII	32 050
18.	XVIII	33 100
19.	XIX	33 600
20.	)(X	34 650
21.	XXI	36 750
22.	XXII	37 800
	XXIII	39 900

VENDIM

Nr. 630, datë 8.7.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.317, DATË 30.5.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME,
DURRËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.317, datë 30.5.2007, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 2 ndryshohet, si me poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për politikat e rritjes së pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR POZICIONET “SPECIALIST”, “PËRGJEGJËS SEKTORI” DHE “DREJTOR”, NË SHËTËPINË E PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURRËS

PAGA MUJORE					
EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtor	III-a	1	2 %		71 000
Përgjegjës sektori	IV-a	1	2 %		43 000
Specialist	IV-b	I ose 2 ose 3	2 %		33 000

Lidhja nr. 2

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore (lekë)	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1	Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)	42 000	5 000
2	Përgjegjës (gjelbërimi, aktivitete të tjera ndihmëse)	34 500	
3	Kuzhinier	31 000	5 000
4	Banakier	31 000	
5	Administrues hoteli	31 000	5 000
6	Ndihmëskuzhinier	28 000	3 000
7	Llogaritar Kamerier Receptionist Mekanik Shofer i titullarit Magazinier	25 000	
8	Elektracist Hidraulik	22 000	3 000
9	Marangoz Bojaxhi	22 000	2 000

10	Punëtor (hoteli) Punëtor (gjelbërimi)	21 000	
11	Punëtor (kuzhine) Punëtor (restoranti)	20 400	
12	Punëtor (lavanteri)	19 000	

Lidhja nr. 4

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

VENDIM

Nr.631, datë 23.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.26, DATË 13.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE PËR VITIN 2010, NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2010, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 89 090 veta, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Gr.	Institucionet buxhetore	Viti 2010
3	Kryeministri	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	767
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	2 163
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 310
10	Ministria e Financave	3 130
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39 030
12	Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 089
13	Ministria e Shëndetësisë	3 444
14	Ministria e Drejtësisë	4 913
15	Aparati i Ministrisë së Punëve të Jashtme	187
	<i>Përfaqësitë diplomatike</i>	428
16	Ministria e Brendshme	13 382
17	Ministria e Mbrojtjes	11 735
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	940
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	29
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 419
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 360
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	215
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	24
78	Ministria e Integritetit	75
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare të cilat:	148
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	35
	- Agjencia Kombëtare e Certifikimit Elektronik	9
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	37
	- Agjencia e Prokurimit Publik	18
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	8
	- Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit	15
	- Agjencia Kombëtare Bërthamore	8
	- Komisioni i Prokurimit Publik	18
88	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	12
	Total	86 180
	Total për Institucionet e Pavarura	2 910
	Total gjithsej	89 090

VENDIM
Nr.632, datë 23.7.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT, TË MËNYRAVE DHE TË
PROCEDURAVE TË DHËNIES NË PËRDORIM E TË TJETËRSIMIT TË PASURIVE TË
KONFISKUARA, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.10 192, DATË 3.12.2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 34 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

1. Procedurave, të parashikuara në këtë vendim, do t'i nënshtrohen të gjitha pasuritë e konfiskuara me vendim gjykatë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor të konfiskimit, i paraqet Ministrit të Financave raportin e vlerësimit tekniko-financiar, për pasurinë e konfiskuar.

3. Agjencia ua përcjell vendimin e gjykatës institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e pasurive. Këto institucione bëjnë kalimin e pronësisë në emër të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Tarifat e shërbimit përballohen nga fondet e Agjencisë. Taksat dhe detyrimet e tjera, të mbartura në ngarkim të pasurisë, deri në çastin e shitjes, përballohen nga Agjencia.

4. Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar, në bazë të raportit tekniko-financiar dhe të nevojave të institucioneve të zbatimit të ligjit, në mbledhjen e radhës, bën rekomandimet për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, të cilat ia paraqet Ministrit të Financave.

5. Ministri i Financave, në bazë të rekomandimeve të Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar e të raportit të vlerësimit tekniko-financiar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vendos për dhënien në përdorim ose tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, si dhe jep udhëzime konkrete për destinacionin, mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive.

KREU II
DHËNIA NË PËRDORIM

1. Institucionet e zbatimit të ligjit, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe organizatat jofitimprurëse, për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të krimit të organizuar, janë subjektet që përfitojnë nga dhënia në përdorim.

2. Format e përdorimit janë:

- a) Kalimi në përgjegjësi administrimi, për institucionet qendrore;
- b) Kalimi në pronësi, për njësitë e qeverisjes vendore;
- c) Dhënia në huapërdorje, për subjektet e tjera përfituese.

3. Për procedurën e dhënies në përdorim të pasurive të konfiskuara, përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë, ku të përcaktohet shprehja e interesit të motivuar e të argumentuar.

4. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara mbikëqyr veprimtarinë e përfituesit në përdorimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Ministri i Financave.

5. Përfituesi i raporton Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Agjencia i raporton, një herë në vit, Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat kundër Krimit të Organizuar për pasuritë e konfiskuara, të dhëna në përdorim, si dhe paraqet raporte me kërkesë të këtij të fundit.

KREU III TJETËRSIMI

1. Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në rastet e tjetërsimit të pasurisë së konfiskuar, ngre një komision për vlerësimin e çmimit të shitjes së pasurisë, i cili ka në përbërje:

- a) një specialist të kësaj Agjencie;
- b) një specialist të Ministrisë së Financave;
- c) një ekspert vlerësues të licencuar.

Për punën e kryer, eksperti vlerësues shpërblehet sipas legjislacionit përkatës, ndërsa anëtarët e tjerë të komisionit shpërblehen me urdhër të Ministrit të Financave.

2. Vlerësimi i pasurive bëhet nga komisioni i vlerësimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut, si dhe duke pasur parasysh llojin e pasurisë, të dhënat e saj, gjendjen fizike, vendndodhjen, destinacionin ekonomik etj. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e kryer dhe për dokumentet e hartuara e të nënshkruara prej tij (genplane, situacione, aktvlerësime etj.).

Komisioni nxjerr vlerësimin përfundimtar, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë, të cilët nuk kanë lidhje me tregun, por që ndikojnë në vlerën reale të shitjes. Raporti i vlerësimit të çmimit të shitjes shoqërohet me raportin e vlerësimit të pasurisë nga eksperti i licencuar dhe, në rastet e shoqërive tregtare, nga raporti i vlerësimit kontabël. Ministri i Financave autorizon kryeadministratorin e AAPSK-së, rast pas rasti, për emërimin e ekspertit kontabël.

3. Dosja me dokumentacionin ligjor dhe vlerësimin i përcillet Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Dosja përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin e gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë referuar dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009;
- b) Procesverbalin për gjendjen fizike të pasurisë në çastin e shitjes, të mbajtur sipas formatit të caktuar nga AAPSK-ja;
- c) Dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë (vërtetim hipotekor + kartelë dhe certifikatë pronësie, nëse ka);
- ç) Aktin e vlerësimit të çmimit të shitjes së pasurisë, të mbajtur nga komisioni përkatës;
- d) Kopje të raportit tekniko-financiar, për pasurinë e konfiskuar.

4. Shitja e pasurive të konfiskuara të bëhet me ankand publik. Procedura e ankandit kryhet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Në komisionin e ankandit merr pjesë edhe një përfaqësues i AAPSK-së, si anëtar.

Pasuria nxirret në ankand dy herë radhazi, në interval kohor jo më pak se 1 (një) muaj. Në ankandin e dytë do të zbatohet i njëjti çmim si në ankandin e parë. Në rast se ankandi dështon dhe herën e dytë, Ministri i Financave, me rekomandim të Komitetit Ndërinstitucional të Ekspertëve, mund të urdhërojë për masën e uljes së çmimit të shitjes.

5. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pasi ka pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, ndërmerr hapat përkatëse për botimin e njoftimit për shitje të objektit, si më poshtë vijon:

- a) Periudha e botimit zgjat 21 (njëzet e një) ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Dita e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin e dërguar nga kjo drejtori për botim. Brenda këtij afati, ky njoftim botohet edhe në një gazetë, me qarkullim kombëtar.

b) Botimin e listës së objekteve, që do të shiten dhe shpalljen e kësaj liste në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, me të dhënat për çdo objekt.

c) Vendosjen nga kjo drejtori, të njoftimit me afishe, fillimisht, në mjediset e saj, për zhvillimin e ankandit të tyre.

6. Njoftimi për botim përmban të dhënat për:

a) vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;

b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit, që do të shitet;

c) vlerën fillestare të ankandit;

ç) sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt.

7. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë drejtori, si dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

8. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, harton dhe arkivon një procesverbal, ku të përcaktohen:

a) kopja e buletinit;

b) kopja e afishimit në gazetë;

c) datat e botimit të njoftimeve;

ç) kopja e njoftimit me afishe.

9. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, në komisionin e ankandit, këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit;

b) Garancinë bankare (apo mandatpagesën) që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të AAPSK-së;

c) Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009.

10. Komisioni i ankandit kryesohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave;

b) Përfaqësuesin e AAPSK-së.

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

11. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

a) Regjistron dhe vërteton identitetin e pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë të përfaqësimit;

b) Prezanton anëtarët e komisionit të ankandit;

c) Deklaron vlerën fillestare të ankandit;

ç) Deklaron hapjen e ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) Drejton marrjen e ofertave;

dh) Shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues të ankandit;

e) Siguron, që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

12. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, ku të shënohen:

a) se regjistrimi i identitetit të pjesëmarrësve në ankand është sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së veçantë të përfaqësimit;

b) emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;

c) deklarimi i vlerës fillestare të ankandit;

ç) deklarimi i hapjes së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) shpallja e personit të fundit, i cili deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

Komisioni i ankandit duhet të sigurojë, që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

13. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, u kthehet 20% e vlerës fillestare, e ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

14. Personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit, pajiset nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, me autorizim, për kalim pronësie, ku përcaktohen qartë detyrimet e blerësit.

15. Blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, është i detyruar të bëjë pagesën në lekë të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand për objektin.

16. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, ai, si fitues ankandi, humbet të drejtën e blerjes dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Paga 20% e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e botimit nga e para, sipas këtij vendimi.

17. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pas pagesës së vlerës së plotë të objektit, është e detyruar ta lidhë kontratën e shitjes ndërmjet palës shitëse (përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, përfaqësuesi i AAPSK-së) dhe blerësit privat.

18. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave dhe përfaqësuesi i AAPSK-së janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit që shitet, brenda 35 (tridhjetë e pesë) ditëve nga data e dhënies së autorizimit, nga Ministria e Financave, blerësit.

Dorëzimi i objektit bëhet, në mënyrë të detyrueshme, nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesi i institucionit administrues (sipas komisionit të vlerësimit të ngritur) në prani të blerësit.

19. Të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi u zbriten detyrimet, ndahen, si më poshtë vijon:

a) 50% e vlerës kalon në fondin e posaçëm, të parashikuar në ligjin nr.10 192, datë 3.12.2009;

b) 50% e vlerës kalon në Buxhetin e Shtetit.

Veprimet kryhen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Detyrimet e përmendura në paragrafin e parë të kësaj pike përcaktohen me hollësi në udhëzimin e Ministrit të Financave.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministri i Financave të hartojë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.633, datë 23.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 1416 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, të njësive të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda kritereve të përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Gr.	Emri i Institucionit	Numri i punonjësve	Emertesa	Koha mesatare	Muajt
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës	24			
	Aparati i ministrisë	1	sanitare	deri 3 ore/dite	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	1	Operatore	deri 5 ore/dite	vjetore
	Inspektoriati Qendror Teknik	1	Sanitar	deri 3 ore/dite	vjetore
	Inspektoriati Qendror Teknik	1	Punetore mirmbajtjeje në laboratore	deri 5 ore/dite	vjetore
	ALBINVEST	1	sanitar	deri 3 ore/dite	vjetore
	Sherbimi Gjeologjik	2	Punetor shpimi	3 -5 ore/dite	vjetore
	Sherbimi Gjeologjik	1	Punetor rievimi	3 -5 ore/dite	vjetore
	Sherbimi Gjeologjik	11	Nepunës roje	8 ore /dite	5 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	5	Punetore	3 -4 ore/dite	7 muaj
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit, Mbrojtjes së Konsumatorit	201			
	QTTB në F. Krujë/Lushnjë/ Shkoder/Vlorë/ Korce	175	Punetore blegtorie/fushe/mekanizator/roje e bazës eksperimentale		
	Ajensia Kombëtare e Duhan Cigareve	12	Punetor fushe	4 ore / dite	Maj-Dhjetor
	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve	2	Teknike	4 ore / dite	Maj-Dhjetor
	DBRUK	12	Punonjes dezinfektimi	8 ore / dite	2 muaj
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	502			
	ALUIZNI	500	Specialiste/ ndihmëspecialiste	8 ore / dite	vjetore
	Drejtoria e Ujësjetës Kanalizime	1	Sanitar	deri 3 ore / dite	vjetore
	IQT	1	Sanitar	deri 4 ore/ dite	vjetore
10	Ministria e Financave	32			
	Sektori i Pagesave të Demshperblimeve	4	Specialiste	8 ore / dite	6 muaj
	Sektori i Pagesave të Demshperblimeve	1	punonjes arkive	8 ore / dite	6 muaj
	Drejt.Financimeve,Kontraktimeve / Dega Thesarit Të	1	Roje	8 ore / dite	6 muaj
	Drejtorinë e Përgj. Financimeve dhe Kontraktimeve	1	Sanitar	deri 3 ore / dite	vjetore
	Degët e Thesarit	7	Sanitar	deri 3 ore / dite	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	4	Operatore	deri 4 ore/ dite	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Elbasan	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Morinë	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Shkoder	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Kakavijë Gjirrokastër	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Tiranë	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Tushemisht	1	Sanitare	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Qaf-Thane	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Dogana Tre-Urat Permet	1	Punetore mirmbajtjeje	3-4 ore/ dite	vjetore
	Sektori i Pagesave të Demshperblimeve	4	Specialiste	8 ore / dite	6 muaj
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	401			
	Sistemi arsimor parauniversitar	41	Sanitare	4ore / dite	shtator-dhjetor
	Instituti i Arkeologjisë	360	Punonjes germimi	8 ore / dite	1 muaj
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	10			
	ZAK Butrint	5	Cicerone	8 ore/ dite	4.5 muaj
	ZAK Butrint	1	Punetore mirmbajtjeje	8 ore/ dite	4.5 muaj
	Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik-Bylis	1	Vezhgues-Ciceron	8 ore/ dite	korrik-shtator
	Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik-Apolloni	1	Vezhgues-Ciceron	8 ore/ dite	korrik-shtator
	Muzeu Kombëtar Gj.K-Krujë	1	Vezhgues-Ciceron	8 ore/ dite	korrik-shtator
	Muzeu Kombëtar Onufri dhe Etnografik Berat	1	Vezhgues-Ciceron	8 ore/ dite	korrik-shtator
3	Ministria e Shëndetësisë	6			
	Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldaiste	8 ore/ dite	4.5 muaj
	Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë	1	Punetore mirmbajtjeje	4 ore/ dite	Mars-Dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Peqin	1	Punetore mirmbajtjeje	4 ore/ dite	Mars-Dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Has	1	Punetore mirmbajtjeje	4 ore/ dite	Mars-Dhjetor
5	Ministria e Jashtme	10			
	Aparati i ministrisë	2	Punetore mirmbajtjeje	6 ore/ dite	vjetore

16	Ministria e Brendshme	136			
	Aparati	1	Specialist perkthyes	8 ore / dite	6 muaj
	Aparati	2	Teknike	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	2	Guzhiner	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	4	Ndihmes/guzhiner	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	2	Kamariere	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Punetore restoranti	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	4	Punetore hoteli	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Receptionist	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Elektricist	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Hidraulik	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Punetor gjelberimi	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Lavanteri	8 ore / dite	6 muaj
	Shtepia e Pushimit Durres	4	Guzhiner	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	4	Ndihmes/guzhiner	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	27	Kamariere	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	7	Punetore guzhine	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	7	Punetore restoranti	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	25	Punetore hoteli	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	3	Receptionist	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Elektricist	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Hidraulik	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	2	Punetor gjelberimi	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Shtepia e Pushimit Durres	1	Lavanteri	8 ore / dite	1 Qershor-10Shtator
	Rezevat Materiale te Shtetit	20	Roje	8 ore / dite	6 muaj
	Rezevat Materiale te Shtetit	5	Punetore Magazine	8 ore / dite	6 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Sanitar	8 ore / dite	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Ndihmes/guzhiner	8 ore / dite	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	1	Punetore mirmbajtjeje	5 ore / dite	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	3	Guzhiner	8 ore / dite	5 muaj
18	Sherbimi i Informativ i Shtetit	36			
	Sherbimi i Informativ i Shtetit	5	Sanitar	3-4 ore/ dite	vjetore
	Sherbimi i Informativ i Shtetit	1	Sanitar	3-4 ore/ dite	6 muaj
	Sherbimi i Informativ i Shtetit	8	Kuzhiner	8 ore/ dite	3 muaj
	Sherbimi i Informativ i Shtetit	4	Banaker	8 ore/ dite	3 muaj
	Sherbimi i Informativ i Shtetit	18	Pastruese	8 ore/ dite	3 muaj
10	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	10			
	Aparati	10	Administratore dokumentash	5 ore/ dite	vjetore
5	Ministria e Punes, Shanseve te Barabarta dhe Ceshtjeve Sociale	35			
	Aparati	4	Roje	8 ore / dite	4 muaj
	Ne institucionet e Shtepise se Foshnjes/Femijeve/ Moshuareve/Qendrat e Zhvillimit/Qendrat Pritese dhe Ditore	21	Mjcke	deri 4 ore / dite	vjetore
		10	Sanitar	deri 4 ore / dite	vjetore
8	Prokuroria e Pergjithshme	9			
	Aparati	2	Perkthyes	5 ore / dite	vjetore
	Prokuroria Tirane	1	Punetore mirmbajtjeje	4 ore / dite	vjetore
	Prokuroria Durres	1	Sanitar	3-4 ore / dite	vjetore
	Prokuroria e Apelit per Krimet e renda	1	Sanitar	3-4 ore / dite	vjetore
	Aparati	4	Perkthyes	8 ore / dite	4 muaj
3	Keshilli i Larte i Drejtesise	1			
	Aparati	1	Stenograf	5 ore / dite	9 muaj
7	Autoriteti i Konkurrences	2			
	Autoriteti i Konkurrences	1	Teknik mirembajtje	5 ore / dite	vjetore
	Autoriteti i Konkurrences	1	Sanitar	3-4 ore / dite	vjetore
	Agjensia e Prokurimit Publik	1			
	Agjensia e Prokurimit Publik	1	Sanitar	3-4 ore / dite	gusht-dhjetor
	Total Numri i Punonjeseve	1416			

VENDIM
Nr.638, datë 28.7.2010

**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË PAGESËS SË KËSHILLTARËVE PROFESIONISTË
DHE AGJENTËVE QË MERREN ME RIATDHESIMIN E VLERAVE MONETARE E TË
PRODUKTEVE TË KRIMIT, TË SEKUESTRUARA BRENDË E JASHTË SHTETIT, DHE
DEBITORËVE TË TJERË TË PËRFSHIRË NË VEPRIMTARINË E FIRMAVE
PIRAMIDALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e pagesës për këshilltarët profesionistë dhe agjentët e kontraktuar nga administratori i shoqërisë huamarrëse, mund të jetë deri në 15% të vlerës së arkëtuar në favor të këtyre shoqërive, nga riatdheshimi i vlerave monetare, të depozituara në banka, të personave të shpallur debitorë dhe aseteve të shoqërive huamarrëse, në administrim të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që ndodhen brenda ose jashtë shtetit, të përfshirë në veprimtarinë e firmave piramidale.

2. Pagesa e këshilltarëve profesionistë apo agjentëve të kontraktuar, sipas pikës 1, të bëhet nga administratori i shoqërisë huamarrëse.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës i Shoqërive Huamarrëse në Administrim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.639, datë 28.7.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E PAGËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT
SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, si dhe të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 1 111 000 (një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekësh, për pagesën e pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të kryetarit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

5873

VENDIM
Nr.640, datë 28.7.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, NË KOMUNËN E FARKËS, QARKU TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në Komunën e Farkës të qarkut të Tiranës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës së Farkës, qarku Tiranë.
3. Pasuritë në sipërfaqen prej 20400 (njëzet mijë e katërqind) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 50 734 800 (pesëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Farkës, planifikuar në buxhetin e vitit 2010.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Farkës.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Farkës, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 20400 (njëzet mijë e katërqind) m² tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Farkës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Farkë e qarkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE”, NË KOMUNËN E
FARKËS, QARKU TIRANË**

Nr	Emër, mbiemër	Sip.arë	Çmimi lekë	Vlera lekë	Dokumenti i pronësisë	Zona kadastrale
1	Ruzhdi Palushi	20400	2487	50734800	Certifikatë pronësie	334/6
	Totali			50 734 800		

VENDIM
Nr.641, datë 28.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, NË BASHKINË E PËRMETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Përmetit.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Përmetit.
 3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 3996 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² tokë arë, pronë private që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 2 197 800 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Përmetit, planifikuar në buxhetin e vitit 2010.
 5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Përmetit.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Përmetit, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3 996 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Përmetit, të bëhet brenda 30 ditëve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Përmetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT”,
NË BASHKINË E PËRMETIT

Nr	Emër, mbiemër	Sip.arë	Çmimi lekë	Vlera lekë	Dokumenti i pronësisë	Zona kadastrale
1	Muço Karafili	1710	550	940500	Certifikatë pronësie	1589
2	Syrja Zengjinasi	1140	550	627000	Vërtetim Pronësie	1589
3	Bramo Krafili	1146	550	630300	Vërtetim pronësie	1589
	Totali	3996		2 197 800		

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.5438, datë 30.6.2010, shpall të vdekur shtetasin Bajram Ismail Maçi, i datëlindjes 10.5.1930.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 30.8.2010
Doli nga shtypi më 31.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë